ЗАПИСНИК

са 8. (осме) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години

Осма редовна седница Скупштине општине Звечан у 2026. години одржана је дана 22.09.2026. године , са почетком у 11.00 часова у скупштинској сали општине Звечан.

Седницом је председавао др Срђан Милосављевић, председавајући Скупштине општине Звечан. Председавајући је у уводном обраћању поздравио градоначелника господина Драгишу Миловића, заменика градоначелника господина Ивана Тодосијевића, представнике Министарства администрације локалне самоуправе (МАЛС), представнике медија, међународних организација, директоре одељења, запослене у општинској администрацији и присутне грађане.

Административни службеник Скупштине општине, господин Милош Недељковић, известио је Скупштину о броју присутних одборника ради утврђивања кворума за рад и одлучивање. Констатовао је да седници присуствује 12 одборника

Седници су присуствовали следећи одборници :

1. Предраг Радовановић
2. Јасминка Млађовић
3. Иван Васић
4. Срђан Милосављевић
5. Милош Радосављевић
6. Радомир Вучовић
7. Лука Јовановић
8. Бранислав Милић
9. Јелена Никић
10. Часлав Софронијевић
11. Зоран Обреновић
12. Ивана Ђокић

Седници нису присуствовали одборници

1. Илир Пеци
2. Радосав Радомировић
3. Марија Јовановић

Председавајући је, на основу члана 46. Закона о локалној самоуправи, констатовао да постоји потребан кворум за рад и пуноправно одлучивање.

Навео је да су одборници, уз позив за седницу, добили материјал за седницу као и предложени дневни ред, који се састојао од следећих тачака.

Дневни ред:

1. Усвајање записника са 7. (седме) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години;
2. Разматрање и доношење Одлуке о усвајању нацрта буџета за 2027. годину са пројекцијама за 2028. и 2029. годину;
3. Разматрање и доношење Одлуке о усвајању правилника о комуналним таксама, накнадама и новчаним казнама у општини Звечан;
4. Разматрање и доношење Одлуке о усвајању општинског плана за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан 2026-2028;
5. Разматрање и доношење Одлуке о подношењу заједничког захтева Скупштине и градоначелника општине Звечан Министарству администрације локалне самоуправе (MALS) за достављање копија документације (позиви, записници, одлуке…) са седница Скупштине општине Звечан за период од 06.11.2022. до 05.12.2025. године;
6. Разно.

Пошто није било предлога за допуну предложени Дневни ред је стављен на гласање и исти је **усвојен једногласно**.

Тачка 1.

Усвајање записника са 7. (седме) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години

Председавајући је позвао одборнике да изнесу евентуалне примедбе на записник. Како није било примедаба, председавајући је ставио на гласање предлог за усвајање записника са 7. (седме) редовне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години.

Након спроведеног гласања, председавајући је констатовао да није било гласова против нити уздржаних, те да је записник са 7.(седме) редовне седнице Скупштине општине Звечан **једногласно усвојен**.

Тачка 2.

Разматрање и доношење Одлуке о усвајању нацрта буџета за 2027. годину са пројекцијама за 2028. и 2029. годину

Председавајући је позвао директорку Директората за буџет и финансије општине Звечан, Мирјану Алагић, да поднесе образложење нацрта буџета општине Звечан за 2027. годину, са пројекцијама за 2028. и 2029. годину.

Директорка Директората за буџет и финансије, Мирјана Алагић, поздравила је присутне и представила предлог буџета општине Звечан за фискалну 2027. годину, са пројекцијама за 2028. и 2029. годину.

У свом излагању навела је да је нацрт буџета припремљен на основу првог буџетског циркулара 2026/1 и Другог буџетског циркулара 2026/2 Министарства финансија, у складу са Законом о локалној самоуправи бр. 03/L-040, Законом о управљању јавним финансијама и одговорности бр. 03/L-048, као и Статутом општине Звечан.

Истакла је да су током припреме буџета одржане две јавне расправе, на којима су грађани изнели предлоге пројеката и исказали потребе локалне заједнице, након чега су надлежни општински директорати прикупили и разматрали предлоге за укључивање у буџет.

Директорка је навела да укупна вредност предложеног буџета општине Звечан за 2027. годину износи 3.384.969 евра. Од укупног износа, за плате и дневнице планирано је 1.991.569 евра, за робу и услуге 537.899 евра, за комуналије 81.800 евра, за субвенције и трансфере 40.000 евра, док је за капиталне инвестиције планирано 733.683 евра. Планирани сопствени приходи за 2027. годину износе 58.679 евра.

Према представљеним пројекцијама, укупан буџет општине Звечан за 2028. годину износи 2.744.048 евра, са планираним сопственим приходима од 61.952 евра, док за 2029. годину укупан буџет износи 2.895.483 евра, са планираним сопственим приходима од 66.839 евра.

У наставку је представљен предлог приоритетних пројеката општине Звечан за период 2027–2029. године, који обухвата пројекте из области објеката, опремања, инфраструктуре и других капиталних улагања.

За 2027. годину предвиђени су следећи пројекти:

1.	Израда пројектне документације и адаптација дела приземља зграде општине за потребе Јединственог услужног места	50.000,00 €
2.	Израда пројектне документације, изградња, реконструкција и опремање отворених спортских терена у Звечану	140.000,00 €

3.	Техничко привођење намени, опремање ентеријера и уређење екстеријера објекта Омладинског центра (Фаза I)	50.000,00 €
4.	Техничко привођење намени и опремање спортске хале у Житковцу (Фаза I)	30.000,00 €
5.	Израда пројектно-техничке документације и свеобухватно унапређење система осветљења јавних површина, спортских и саобраћајних објеката у Звечану	55.000,00 €
6.	Санација постојећих асфалтних површина испред колективно-стамбених објеката у улици Немањића	30.000,00 €
7.	Санација, обнова и функционално уређење јавних сеоских чесми у Грабовцу, Србовцу, Кориљу и Рудару	30.000,00 €
8.	Санација и текуће одржавање постојеће локалне водоводне мреже у Србовцу	20.000,00 €
9.	Свеобухватна санација, рехабилитација и текуће одржавање локалне путне и уличне мреже на територији општине Звечан, уз израду пројектно-техничке документације по потреби (асфалтирање и насипање градских и сеоских саобраћајница)	225.121,00 €
10.	Израда пројектно-техничке документације и изградња потпорног зида и санација моста у Кориљу	20.000,00 €
11.	Свеобухватна санација, рехабилитација и инфраструктурно уређење у насељу Матица, уз израду пројектно-техничке документације по потреби (изградња атмосферске канализације, санација потпорних зидова и путева, уз могуће проширење саобраћајнице)	30.000,00€
12.	Израда пројектно-техничке документације и изградња анекса школе „Исо Бољетин“ за потребе предшколске установе, са пратећим партерним уређењем	31.562,00 €
13.	Реновирање и унутрашње уређење просторија канцеларије локалне заједнице у Липи	22.000,00 €

Наведено је да укупна планирана вредност капиталних пројеката за 2027. годину износи 733.683 евра.

За 2028. и 2029. годину предвиђен је пројекат свеобухватне санације и функционалног привођења намени комплекса „Рајска Бања“ у Бањској.

Директорка је на крају излагања истакла да су предложени капитални пројекти усмерени на унапређење јавне инфраструктуре, објеката, саобраћајне и комуналне инфраструктуре, спортских и других објеката од значаја за локалну заједницу.

*

Након излагања, председавајући је захвалио директорки Директората за буџет и финансије и отворио расправу по овој тачки дневног реда. Како није било пријављених за реч, председавајући је ставио на гласање Нацрт буџета општине Звечан за 2027. годину, са пројекцијама за 2028. и 2029. годину.

Након спроведеног гласања, **11** одборника је гласало **ЗА** док је **1** био **УЗДРЖАН**.

На основу резултата гласања, председавајући је констатовао да је **Скупштина општине Звечан већином гласова присутних одборника донела Одлуку о усвајању буџета општине Звечан за 2027. годину, са пројекцијама за 2028. и 2029. годину.**

Тачка 3.

Разматрање и доношење Одлуке о усвајању правилника о комуналним таксама, накнадама и новчаним казнама у општини Звечан;

Председавајући је отворио трећу тачку дневног реда и дао реч известиоцу по овој тачки, члану Комисије за припрему Правилника, Лиридону Пецију, да поднесе образложење.

*

Лиридон Пеци, члан радне групе за израду Правилника о општинским таксама, накнадама и новчаним казнама у општини Звечан, укратко је представио Правилник и рад који је радна група спровела током његове израде.

У свом излагању навео је да је Правилник израђен на основу Одлуке председника општине Звечан, др Драгише Миловића, којом је формирана радна група за његову израду. Истакао је да је циљ радне групе био да се припреми јасан, применљив и професионалан акт, прилагођен потребама општине Звечан и њених грађана.

Правилником се утврђују активности и услуге које подлежу општинским таксама и накнадама, висина такси и накнада, категорије лица које могу бити ослобођене плаћања, као и питања која се односе на прекршаје и санкције за кршење његових одредаба.

Током израде Правилника, радна група је разматрала предлоге и потребе организационих јединица општинске управе, са циљем да се таксе и накнаде утврде на јасан и практично применљив начин.

У припрему Правилника биле су укључене следеће дирекције и области општинске управе:

1. Дирекција за администрацију и кадрове, са таксама и накнадама за издавање уверења и службених докумената, као и услугама Цивилног регистра;
2. Дирекција за економски развој, која обухвата таксе и накнаде повезане са обављањем пословних делатности и различитим категоријама предузећа;
3. Дирекција за здравство и социјалну заштиту, у оквиру које су разматране накнаде у области здравства и социјалне заштите;
4. Дирекција за социјалне и резиденцијалне услуге, у оквиру које су утврђене накнаде за услуге Центра за социјални рад;
5. Дирекција за планирање и животну средину, која обухвата таксе и накнаде повезане са планирањем, животном средином и одговарајућим услугама;
6. Дирекција за катастар и геодезију, у оквиру које су разматране накнаде за катастарске и геодетске производе и услуге, као и услуге регистрације имовине;
7. Дирекција за пољопривреду, шумарство и рурални развој, са накнадама које се односе на област пољопривреде, шумарства и руралног развоја;
8. Дирекција за образовање и науку, са одговарајућим накнадама у области образовања;
9. Дирекција за јавне услуге, цивилну заштиту, ватрогаство и инфраструктуру, за услуге и активности из надлежности ове области;
10. Дирекција инспектората, за таксе и накнаде које се односе на инспекцијску делатност;
11. Дирекција за културу, омладину и спорт, са одговарајућим накнадама у области културе, омладине и спорта.

У наставку излагања истакнуто је да Правилник има широк обухват и да укључује значајан број услуга које Општина пружа грађанима и другим корисницима.

Посебна пажња током израде била је посвећена утврђивању одговарајућег нивоа такси и накнада, при чему се водило рачуна о потреби да се грађани и привредни субјекти не оптерећују непотребним трошковима, уз истовремено обезбеђивање стабилних прихода Општине за пружање јавних услуга и извршавање њених законских надлежности.

Као важни принципи у изради Правилника истакнути су транспарентност, јасноћа и једнако поступање. Правилником су утврђене и категорије лица која могу бити ослобођена плаћања, као и начин доказивања права на ослобађање.

Такође је истакнута важност укључивања грађана кроз спроведену јавну расправу о Правилнику, чиме је омогућено да грађани и заинтересоване стране изнесу своје коментаре, примедбе и сугестије. Наглашено је да су општинске таксе и накнаде непосредно повезане са грађанима, привредним субјектима и корисницима општинских услуга.

На крају излагања, Пеци је истакао да Правилник представља основу за јасније и транспарентније уређење области општинских такси и накнада, како би грађани, привредни субјекти и други корисници општинских услуга имали јасне информације о врсти услуге, висини обавезе и основу за њено утврђивање.

Известилац је захвалио председнику општине на институционалној подршци процесу израде Правилника, као и члановима радне групе и директорима општинских дирекција на њиховом доприносу у припреми документа.

*

Након излагања известиоца, председавајући је отворио расправу по овој тачки дневног реда и позвао одборнике да се пријаве за реч. Како није било пријављених за реч, председавајући је ставио на гласање Одлуку о усвајању Правилника о комуналним таксама, накнадама и новчаним казнама у општини Звечан.

Одлука је **усвојена једногласно**, није било гласова против, нити уздржаних.

Председавајући је констатовао да је Скупштина општине Звечан на својој 8. редовној седници у 2026. години једногласно донела **Одлуку о усвајању Правилника о комуналним таксама, накнадама и новчаним казнама у општини Звечан.**

Тачка 4.

Разматрање и доношење Одлуке о усвајању општинског плана за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан за период 2026–2028. године;

Председавајући је отворио четврту тачку дневног реда и позвао Агрона Кељмендија, представника Комисије за израду плана, да представи општински план за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан за период 2026–2028. године.

*

Агрон Кељменди је, у својству члана Комисије, представио општински план и укратко образложио његову сврху и основне циљеве.

У свом излагању навео је да план има за циљ успостављање координисаног и одрживог приступа реинтеграцији репатрираних лица и интеграцији странаца на територији општине Звечан, уз обезбеђивање бољег приступа услугама и институционалној подршци.

Истакао је да план предвиђа конкретне мере и активности усмерене на олакшавање социјалног и економског укључивања наведених категорија, као и на јачање сарадње и координације између локалних институција.

Такође је навео да је план претходно достављен одборницима путем електронске поште, како би им било омогућено да се упознају са његовим садржајем и размотре предложена решења.

На крају излагања, Агрон Кељменди је позвао одборнике да подрже и усвоје општински план за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан за период 2026–2028. године.

*

Након излагања известиоца, председавајући је отворио расправу по овој тачки дневног реда и позвао одборнике да се пријаве за реч. Како није било дискусије, председавајући је ставио на гласање предлог Општинског плана за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан за период 2026–2028. године.

Одлука о усвајању плана је донета **једногласно,** није било гласова против нити уздржаних.

Председавајући је констатовао да је Скупштина општине Звечан на својој 8. редовној седници у 2026. години једногласно донела одлуку о усвајању **Општинског плана за одрживу реинтеграцију репатрираних лица и интеграцију странаца у општини Звечан за период 2026–2028. године.**

Тачка 5.

Разматрање и доношење Одлуке о подношењу заједничког захтева Скупштине и градоначелника општине Звечан Министарству администрације локалне самоуправе (MALS) за достављање копија документације (позиви, записници, одлуке и друго) са седница Скупштине општине Звечан за период од 06.11.2022. до 05.12.2025. године.

Председавајући је отворио пету тачку дневног реда и образложио разлоге за њено увртавање у дневни ред седнице. У свом излагању навео је да је приликом ступања на дужност председавајућег Скупштине општине Звечан и председника Општине Звечан, од стране претходне председнице Скупштине предат само део документације, који је обухватао неколико правилника и одлука. Значајан део документације који се односи на рад и седнице Скупштине општине Звечан у периоду од 2022. до 2025. године, односно до ступања на дужност новог сазива, није достављен и остао је недоступан Скупштини.

Истакао је да су у више наврата предузимане активности ради прибављања недостајуће документације, како од стране Скупштине општине, тако и од стране председавајућег. Тим поводом, председавајући се 30. марта 2026. године обратио Министарству администрације и локалне самоуправе са захтевом за достављање недостајуће документације.

Након неколико недеља, Министарство је доставило одговор да је спремно да тражену документацију доставља сукцесивно у наредном периоду. Међутим, како је од упућивања захтева прошло више месеци, а Скупштини општине Звечан до дана одржавања седнице није достављена тражена документација, предложено је да се о овом питању донесе посебна одлука.

Председавајући је навео да је, у консултацији са председником општине Звечан, предложено да Скупштина донесе одлуку којом ће се председник општине Звечан, др Драгиша Миловић и председавајући Скупштине општине Звечан заједнички обратити Министарству администрације и локалне самоуправе са захтевом за достављање целокупне недостајуће документације која се односи на рад Скупштине општине Звечан у наведеном периоду.

Посебно је истакнуто да се не тражи само списак донетих одлука, већ копије целокупне документације са седница Скупштине, укључујући позиве за седнице, записнике и одлуке донете на основу разматрања питања на седницама, као и потврде валидности донетих одлука од стране надлежних министарстава.

Након образложења, председавајући је отворио расправу по овој тачки дневног реда. Како није било пријављених за реч, приступило се гласању о Предлогу одлуке о подношењу заједничког захтева Скупштине општине и председника општине Звечан Министарству администрације и локалне самоуправе за достављање копија документације са седница Скупштине општине Звечан за период од 06.11.2022. до 05.12.2025. године.

Одлука је донета **једногласно,** није било гласова против нити уздржаних.

Председавајући је констатовао да је Скупштина општине Звечан на својој 8. редовној седници у 2026. години једногласно донела **Одлуку о подношењу заједничког захтева Скупштине општине и председника општине Звечан Министарству администрације локалне самоуправе за достављање копија документације са седница Скупштине општине Звечан за период од 06.11.2022. до 05.12.2025. године.**

Тачка 6.

Разно

Како није било пријављених за реч, председавајући је констатовао да је 8. редовна седница Скупштине општине Звечан у 2026. години завршена у 11.34 часова.

Председавајући је захвалио свим присутнима на издвојеном времену и учешћу у раду седнице.

У Звечану,

Дана: 22.09.2026.

Записничар:

Милош Недељковић, мастер правник,
административни асистент Скупштине

Председавајући Скупштине
општине Звечан

Др Срђан Милосављевић

PROCESVERBAL

nga mbledhja e 8-të (tetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026

Mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026 u mbajt më 22.09.2026, me fillim në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Zveçanit.

Mbledhjen e kryesoi dr. Srdjan Milosavljević, kryesues i Kuvendit të Komunës së Zveçanit. Në fjalën hyrëse, kryesuesi përshëndeti kryetarin e komunës, z. Dragiša Milović, nënkryetarin e komunës, z. Ivan Todosijević, përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përfaqësuesit e mediave, organizatave ndërkombëtare, drejtorët e drejtorive, të punësuarit në administratën komunale dhe qytetarët e pranishëm.

Zyrtari administrativ i Kuvendit të Komunës, z. Miloš Nedeljković, e njoftoi Kuvendin për numrin e anëtarëve të pranishëm, me qëllim të konstatimit të kuorumit për punë dhe vendimmarrje. Ai konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 12 anëtarë të Kuvendit.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e mëposhtëm të Kuvendit:

1. Predrag Radovanović
2. Jasminka Mlađović
3. Ivan Vasić
4. Srdjan Milosavljević
5. Miloš Radosavljević
6. Radomir Vučović
7. Luka Jovanović
8. Branislav Milić
9. Jelena Nikić
10. Časlav Sofronijević
11. Zoran Obrenović
12. Ivana Đokić

Në mbledhje nuk morën pjesë anëtarët e Kuvendit:

1. Ilir Peci
2. Radosav Radomirović
3. Marija Jovanović

Kryesuesi, në bazë të nenit 46 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, konstatoi se ekziston kuorumi i nevojshëm për punë dhe vendimmarrje të plotfuqishme.

Ai theksoi se anëtarët e Kuvendit, së bashku me ftesën për mbledhje, kishin marrë materialin për mbledhje, si dhe rendin e propozuar të ditës, i cili përbëhej nga pikat e mëposhtme.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 7-të (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e Rregullores për taksat komunale, tarifat dhe gjobat në Komunën e Zveçanit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit 2026–2028;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për paraqitjen e kërkesës së përbashkët të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës së Zveçanit drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për dorëzimin e kopjeve të dokumentacionit (ftesa, procesverbale, vendime...) nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Zveçanit për periudhën nga 06.11.2022 deri më 05.12.2025;
6. Të ndryshme.

Meqenëse nuk kishte propozime për plotësim, rendi i propozuar i ditës u hodh në votim dhe u miratua njëzëri.

Pika 1.

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 7-të (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Kuvendit që të paraqesin vërejtjet eventuale për procesverbalin. Meqenëse nuk kishte vërejtje, kryesuesi e hodhi në votim propozimin për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e 7-të (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se nuk kishte vota kundër dhe as abstenime, dhe se procesverbali nga mbledhja e 7-të (shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit u miratua njëzëri.

Pika 2.

Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029

Kryesuesi e ftoi drejtoreshën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Zveçanit, Mirjana Alagić, që të paraqesë arsyetimin e projektbuxhetit të Komunës së Zveçanit për vitin 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029.

Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Mirjana Alagić, i përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti propozimin e buxhetit të Komunës së Zveçanit për vitin fiskal 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029.

Në prezantimin e saj, ajo theksoi se projektbuxheti është përgatitur në bazë të Qarkores së parë buxhetore 2026/1 dhe Qarkores së dytë buxhetore 2026/2 të Ministrisë së Financave, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, si dhe Statutin e Komunës së Zveçanit.

Ajo theksoi se gjatë përgatitjes së buxhetit janë mbajtur dy diskutime publike, në të cilat qytetarët paraqitën propozime për projekte dhe shprehën nevojat e komunitetit lokal, pas së cilës drejtoritë kompetente komunale i grumbulluan dhe i shqyrtuan propozimet për përfshirje në buxhet.

Drejtoresha theksoi se vlera e përgjithshme e buxhetit të propozuar të Komunës së Zveçanit për vitin 2027 është 3.384.969 euro. Nga shuma e përgjithshme, për paga dhe mëditje janë planifikuar 1.991.569 euro, për mallra dhe shërbime 537.899 euro, për shpenzime komunale 81.800 euro, për subvencione dhe transfere 40.000 euro, ndërsa për investime kapitale janë planifikuar 733.683 euro. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2027 janë 58.679 euro.

Sipas projeksioneve të paraqitura, buxheti i përgjithshëm i Komunës së Zveçanit për vitin 2028 është 2.744.048 euro, me të hyra vetanake të planifikuara prej 61.952 euro, ndërsa për vitin 2029 buxheti i përgjithshëm është 2.895.483 euro, me të hyra vetanake të planifikuara prej 66.839 euro.

Në vazhdim u paraqit propozimi i projekteve prioritare të Komunës së Zveçanit për periudhën 2027–2029, i cili përfshin projekte në fushën e objekteve, pajisjeve, infrastrukturës dhe investimeve të tjera kapitale.

Për vitin 2027 janë paraparë projektet e mëposhtme:

1.	Përgatitja e dokumentacionit të projektit dhe përshtatja e një pjese të përdhesës së ndërtesës së komunës për nevojat e Pikës së Vetme të Shërbimit	50.000,00 €

2.	Përgatitja e dokumentacionit të projektit, ndërtimi, rindërtimi dhe pajisja e terreneve të hapura sportive në Zveçan	140.000,00 €
3.	Përshtatja teknike për përdorim, pajisja e brendshme dhe rregullimi i hapësirës së jashtme të objektit të Qendrës Rinore (Faza I)	50.000,00 €
4.	Përshtatja teknike për përdorim dhe pajisja e sallës sportive në Zhitkoc (Faza I)	30.000,00 €
5.	Përgatitja e dokumentacionit projektues-teknik dhe përmirësimi gjithëpërfshirës i sistemit të ndriçimit të hapësirave publike, objekteve sportive dhe të trafikut në Zveçan	55.000,00 €
6.	Sanimi i sipërfaqeve ekzistuese të asfaltuara para objekteve kolektive të banimit në rrugën Nemanjića	30.000,00 €
7.	Sanimi, renovimi dhe rregullimi funksional i krojeve publike të fshatit në Graboc, Srboc, Korilje dhe Rudar	30.000,00 €
8.	Sanimi dhe mirëmbajtja e rregullt e rrjetit ekzistues lokal të ujësjellësit në Srboc	20.000,00 €
9.	Sanimi gjithëpërfshirës, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rregullt e rrjetit lokal rrugor dhe të rrugicave në territorin e Komunës së Zveçanit, me përgatitjen e dokumentacionit projektues-teknik sipas nevojës (asfaltimi dhe mbushja e rrugëve urbane dhe rurale)	225.121,00 €
10.	Përgatitja e dokumentacionit projektues-teknik dhe ndërtimi i murit mbajtës, si dhe sanimi i urës në Korilje	20.000,00 €
11.	Sanimi gjithëpërfshirës, rehabilitimi dhe rregullimi infrastrukturor në lagjen Matica, me përgatitjen e dokumentacionit projektues-teknik sipas nevojës (ndërtimi i kanalizimit atmosferik, sanimi i mureve mbajtëse dhe rrugëve, me mundësi të zgjerimit të rrugës)	30.000,00€
12.	Përgatitja e dokumentacionit projektues-teknik dhe ndërtimi i aneksit të shkollës "Isa Boletini" për nevojat e institucionit parashkollor, me rregullimin përcjellës të hapësirës së jashtme	31.562,00 €

13.	Renovimi dhe rregullimi i brendshëm i hapësirave të zyrës së bashkësisë lokale në Lipë	22.000,00 €

U theksua se vlera e përgjithshme e planifikuar e projekteve kapitale për vitin 2027 është 733.683 euro.

Për vitet 2028 dhe 2029 është paraparë projekti i sanimit gjithëpërfshirës dhe vënies funksionale në përdorim të kompleksit "Rajska Banja" në Banjskë.

Në fund të prezantimit, drejtoresha theksoi se projektet kapitale të propozuara synojnë përmirësimin e infrastrukturës publike, objekteve, infrastrukturës rrugore dhe komunale, objekteve sportive dhe objekteve të tjera me rëndësi për komunitetin lokal.

*

Pas prezantimit, kryesuesi e falënderoi drejtoreshën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Meqenëse nuk kishte të paraqitur për fjalë, kryesuesi e hodhi në votim Projektbuxhetin e Komunës së Zveçanit për vitin 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029.

Pas votimit, 11 anëtarë të Kuvendit votuan PËR, ndërsa 1 ABSTENOI.

Në bazë të rezultatit të votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi Vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Zveçanit për vitin 2027, me projeksione për vitet 2028 dhe 2029.

Pika 3.

Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e Rregullores për taksat komunale, tarifat dhe gjobat në Komunën e Zveçanit;

Kryesuesi hapi pikën e tretë të rendit të ditës dhe ia dha fjalën raportuesit për këtë pikë, anëtarit të Komisionit për përgatitjen e Rregullores, Liridon Pecit, që të paraqesë arsyetimin.

*

Liridon Peci, anëtar i grupit punues për hartimin e Rregullores për taksat komunale, tarifat dhe gjobat në Komunën e Zveçanit, paraqiti shkurtimisht Rregulloren dhe punën që grupi punues kishte zhvilluar gjatë hartimit të saj.

Në prezantimin e tij, ai theksoi se Rregullorja është hartuar në bazë të Vendimit të kryetarit të Komunës së Zveçanit, dr. Dragiša Milović, me të cilin është formuar grupi punues për hartimin e saj. Ai theksoi se qëllimi i grupit punues ishte përgatitja e një akti të qartë, të zbatueshëm dhe profesional, të përshtatur me nevojat e Komunës së Zveçanit dhe qytetarëve të saj.

Me Rregullore përcaktohen aktivitetet dhe shërbimet që u nënshtrohen taksave dhe tarifave komunale, lartësia e taksave dhe tarifave, kategoritë e personave që mund të lirohen nga pagesa, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me kundërvajtjet dhe sanksionet për shkeljen e dispozitave të saj.

Gjatë hartimit të Rregullores, grupi punues shqyrtoi propozimet dhe nevojat e njësive organizative të administratës komunale, me qëllim që taksat dhe tarifat të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe praktikisht të zbatueshme.

Në përgatitjen e Rregullores ishin të përfshira drejtoritë dhe fushat e mëposhtme të administratës komunale:

1. Drejtoria për Administratë dhe Personel, me taksat dhe tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare, si dhe shërbimet e Gjendjes Civile;
2. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, e cila përfshin taksat dhe tarifat që lidhen me ushtrimin e veprimtarive afariste dhe kategori të ndryshme të ndërmarrjeve;
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të së cilës janë shqyrtuar tarifat në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
4. Drejtoria për Shërbime Sociale dhe Rezidenciale, në kuadër të së cilës janë përcaktuar tarifat për shërbimet e Qendrës për Punë Sociale;
5. Drejtoria për Planifikim dhe Mjedis, e cila përfshin taksat dhe tarifat që lidhen me planifikimin, mjedisin dhe shërbimet përkatëse;
6. Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, në kuadër të së cilës janë shqyrtuar tarifat për produktet dhe shërbimet kadastrale dhe gjeodezike, si dhe shërbimet e regjistrimit të pronës;
7. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me tarifat që lidhen me fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;
8. Drejtoria për Arsim dhe Shkencë, me tarifat përkatëse në fushën e arsimit;
9. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje Civile, Zjarrfikje dhe Infrastrukturë, për shërbimet dhe aktivitetet nga kompetenca e kësaj fushe;
10. Drejtoria e Inspektoratit, për taksat dhe tarifat që lidhen me veprimtarinë inspektuese;
11. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me tarifat përkatëse në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Në vazhdim të prezantimit u theksua se Rregullorja ka një fushëveprim të gjerë dhe përfshin një numër të konsiderueshëm të shërbimeve që Komuna u ofron qytetarëve dhe shfrytëzuesve të tjerë.

Gjatë hartimit, vëmendje e veçantë iu kushtua përcaktimit të nivelit të përshtatshëm të taksave dhe tarifave, duke pasur parasysh nevojën që qytetarët dhe subjektet ekonomike të mos ngarkohen me shpenzime të panevojshme, ndërsa njëkohësisht të sigurohen të hyra të qëndrueshme të Komunës për ofrimin e shërbimeve publike dhe ushtrimin e kompetencave të saj ligjore.

Si parime të rëndësishme në hartimin e Rregullores u theksuan transparenca, qartësia dhe trajtimi i barabartë. Me Rregullore janë përcaktuar edhe kategoritë e personave që mund të lirohen nga pagesa, si dhe mënyra e dëshmimit të së drejtës për lirim.

Gjithashtu u theksua rëndësia e përfshirjes së qytetarëve përmes diskutimit publik të zhvilluar për Rregulloren, me ç'rast qytetarëve dhe palëve të interesuara iu mundësua të paraqesin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. U theksua se taksat dhe tarifat komunale lidhen drejtpërdrejt me qytetarët, subjektet ekonomike dhe shfrytëzuesit e shërbimeve komunale.

Në fund të prezantimit, Peci theksoi se Rregullorja paraqet bazë për rregullim më të qartë dhe më transparent të fushës së taksave dhe tarifave komunale, në mënyrë që qytetarët, subjektet ekonomike dhe shfrytëzuesit e tjerë të shërbimeve komunale të kenë informata të qarta për llojin e shërbimit, lartësinë e obligimit dhe bazën për përcaktimin e tij.

Raportuesi e falënderoi kryetarin e komunës për mbështetjen institucionale në procesin e hartimit të Rregullores, si dhe anëtarët e grupit punues dhe drejtorët e drejtorive komunale për kontributin e tyre në përgatitjen e dokumentit.

*

Pas prezantimit të raportuesit, kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës dhe i ftoi anëtarët e Kuvendit që të paraqiten për fjalë. Meqenëse nuk kishte të paraqitur për fjalë, kryesuesi e hodhi në votim Vendimin për miratimin e Rregullores për taksat komunale, tarifat dhe gjobat në Komunën e Zveçanit.

Vendimi u miratua njëzëri; nuk pati vota kundër dhe as abstenime.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit, në mbledhjen e tij të 8-të të rregullt në vitin 2026, miratoi njëzëri Vendimin për miratimin e Rregullores për taksat komunale, tarifat dhe gjobat në Komunën e Zveçanit.

Pika 4.

Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për miratimin e Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit për periudhën 2026–2028;

Kryesuesi hapi pikën e katërt të rendit të ditës dhe e ftoi Agron Kelmendin, përfaqësues të Komisionit për hartimin e planit, që të paraqesë Planin Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit për periudhën 2026–2028.

*

Agron Kelmendi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit, paraqiti planin komunal dhe shkurtimisht arsyetoi qëllimin dhe objektivat kryesore të tij.

Në prezantimin e tij, ai theksoi se plani synon vendosjen e një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj riintegrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve në territorin e Komunës së Zveçanit, duke siguruar qasje më të mirë në shërbime dhe mbështetje institucionale.

Ai theksoi se plani parasheh masa dhe aktivitete konkrete të orientuara drejt lehtësimit të përfshirjes sociale dhe ekonomike të kategorive të lartpërmendura, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve lokale.

Gjithashtu, ai theksoi se plani u ishte dërguar më herët anëtarëve të Kuvendit përmes postës elektronike, në mënyrë që t'u mundësohej të njiheshin me përmbajtjen e tij dhe të shqyrtonin zgjidhjet e propozuara.

Në fund të prezantimit, Agron Kelmendi i ftoi anëtarët e Kuvendit që ta mbështesin dhe miratojnë Planin Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit për periudhën 2026–2028.

*

Pas prezantimit të raportuesit, kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës dhe i ftoi anëtarët e Kuvendit që të paraqiten për fjalë. Meqenëse nuk pati diskutim, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit për periudhën 2026–2028.

Vendimi për miratimin e planit u miratua njëzëri; nuk pati vota kundër dhe as abstenime.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit, në mbledhjen e tij të 8-të të rregullt në vitin 2026, miratoi njëzëri Vendimin për miratimin e Planit Komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Zveçanit për periudhën 2026–2028.

Pika 5.

Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për paraqitjen e kërkesës së përbashkët të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës së Zveçanit drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për dorëzimin e kopjeve të dokumentacionit (ftesa, procesverbale, vendime dhe të tjera) nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Zveçanit për periudhën nga 06.11.2022 deri më 05.12.2025.

Kryesuesi hapi pikën e pestë të rendit të ditës dhe arsyetoi shkaqet e përfshirjes së saj në rendin e ditës së mbledhjes. Në prezantimin e tij, ai theksoi se, me rastin e marrjes së detyrës nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Zveçanit dhe kryetari i Komunës së Zveçanit, nga ish-kryesuesja e Kuvendit ishte dorëzuar vetëm një pjesë e dokumentacionit, e cila përfshinte disa rregullore dhe vendime. Një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit që lidhet me punën dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në periudhën 2022–2025, përkatësisht deri në marrjen e detyrës nga përbërja e re, nuk ishte dorëzuar dhe kishte mbetur e paarritshme për Kuvendin.

Ai theksoi se në disa raste janë ndërmarrë aktivitete për sigurimin e dokumentacionit që mungon, si nga Kuvendi i Komunës ashtu edhe nga kryesuesi. Lidhur me këtë, më 30 mars 2026, kryesuesi iu drejtua Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kërkesë për dorëzimin e dokumentacionit që mungon.

Pas disa javësh, Ministria dërgoi përgjigje se ishte e gatshme që dokumentacionin e kërkuar ta dorëzonte në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë periudhës në vijim. Megjithatë, pasi kishin kaluar disa muaj nga paraqitja e kërkesës dhe dokumentacioni i kërkuar nuk i ishte dorëzuar Kuvendit të Komunës së Zveçanit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes, u propozua që për këtë çështje të merret një vendim i veçantë.

Kryesuesi theksoi se, në konsultim me kryetarin e Komunës së Zveçanit, ishte propozuar që Kuvendi të marrë vendim me të cilin kryetari i Komunës së Zveçanit, dr. Dragiša Milović, dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Zveçanit, bashkërisht t'i drejtohen Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me kërkesë për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që mungon dhe që lidhet me punën e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në periudhën e lartpërmendur.

Në veçanti u theksua se nuk kërkohet vetëm lista e vendimeve të miratuara, por kopjet e të gjithë dokumentacionit nga mbledhjet e Kuvendit, duke përfshirë ftesat për mbledhje, procesverbalet dhe vendimet e marra në bazë të shqyrtimit të çështjeve në mbledhje, si dhe vërtetimet e vlefshmërisë së vendimeve të miratuara nga ministritë kompetente.

Pas arsyetimit, kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës. Meqenëse nuk kishte të paraqitur për fjalë, u kalua në votimin e Propozim-vendimit për paraqitjen e kërkesës së përbashkët të Kuvendit të Komunës dhe kryetarit të Komunës së Zveçanit drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për dorëzimin e kopjeve të dokumentacionit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Zveçanit për periudhën nga 06.11.2022 deri më 05.12.2025.

Vendimi u miratua njëzëri; nuk pati vota kundër dhe as abstenime.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Komunës së Zveçanit, në mbledhjen e tij të 8-të të rregullt në vitin 2026, miratoi njëzëri Vendimin për paraqitjen e kërkesës së përbashkët të Kuvendit të Komunës dhe kryetarit të Komunës së Zveçanit drejtuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për dorëzimin e kopjeve të dokumentacionit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Zveçanit për periudhën nga 06.11.2022 deri më 05.12.2025.

Pika 6.

Të ndryshme

Meqenëse nuk kishte të paraqitur për fjalë, kryesuesi konstatoi se mbledhja e 8-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026 përfundoi në ora 11:34.

Kryesuesi i falënderoi të gjithë të pranishmit për kohën e ndarë dhe pjesëmarrjen në punën e mbledhjes.

Në Zveçan,

Më datë: 22.09.2026.

Procesmbajtësi:

Miloš Nedeljković, master jurist,
asistent administrativ i Kuvendit

Kryesuesi i Kuvendit të
Komunës së Zveçanit

Dr Srdjan Milosavljević